POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 23 vjeçari grek grabit shqiptarin në rrugë, por s'i kishte bërë mirë llogaritë! 54-vjeçari e ndjek, i jep 'një dru të mirë' dhe ia dorëzon policisë

2 'Jo se nuk doja, por...', Eranda Libohova rrëfen pse nuk është martuar: Jam një virgjëreshë që ja mbath

3 Sherr në përfundim të ndeshjes! Lojtari i Tiranës valvit flamurin në mesin e fushës, ndërhyjnë ata të Partizanit (VIDEO)

4  Kush janë shqiptarët e arrestuar në Angli, morën peng fierakun pas sherrit për 'shtëpitë e barit' dhe kërkonin 400 mijë dollarë

5 Akademia e Shkencave risjell për herë të dytë në Shqipëri një nga konferencat më mëdha të shkencës

Kronikë

Pesë persona të armatosur e të maskuar grabisin një shtëpi në Klos, autorët lidhën nënë e bir dhe i dhunuan! Marrin 8 mijë euro e sende me vlerë

*Një shtëpi u grabit me armë në fshatin Dom te Klosit. Pesë persona të maskuar, nën kërcënimin e armës dhunuan dhe lidhën anëtarët e familjes Lleshi dhe më pas morën 8 mijë euro, 1 milion lekë dhe sende të tjera me vlerë. Policia bënë me dije se **janë shoqëruar gjashtë persona** në lidhje me ngjarjen.*

Dhunimi dhe grabitja e familjes në Klos, deputetja e PD-së: Prokuroria të zbardhë ngjarjen

Redaksia
2 Tetor, 09:28 | **Përditesimi: 2 Tetor, 20:19**

Një grabitje me armë zjarri u regjistrua në fshatin Dom të Bashkisë së Klosit. Ngjarja ndodhi rreth orës 03.30 të mëngjesit të kësaj të diele, ku 5 persona të armatosur me maska grabitën një banesë në fshati. Paraprakisht dyshohet se grabitësit morën rreth 8 mijë euro, 1 milion lekë dhe sende të tjera me vlerë.

Grabitësit hynë me forcë duke shqyer dyert e shtëpisë, rrahën me qytat e armëve anëtarët e familjes Përparim Lleshi dhe më pas i lidhën me litar.


LEXO EDHE:
Rrihte vazhdimisht gruan, ndërsa vajza e mitur konsumoi mbidozë ilaçesh nga dhuna psikologjike e të atit! Në pranga 42-vjeçari në Maqellarë!

Një i njohur i familjes rrëfen tmerrin që të afërmit e tij përjetuan nga grabitësit. Ai thotë se djali ka pësuar fraktura të mëdha në kokë, (4 fraktura) dhe nëna po ashtu, pasi janë goditur me qytën e automatikut.

> *"Çunin e familjes e kanë rrahur tmerrësisht, e kanë lidhur dhe më pas i kanë vjedhur. Si lagje nuk na ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë. Se dimë se ça po hyn e ça po del. Kush bën kështu veprimesh, duhet pushkatuar. Po është hequr pushkatimi. Ishte nëna me fëmijën vetëm në shtëpi", tha i afërmi, që është dhe banor i zonës.*

Policia ndërkohë shoqëroi gjashtë persona në Komisariat në lidhje me ngjarjen, ndërsa vijon kontrolli i zonës për kapjen e personave të përfshirë në këtë ngjarje, pasi nuk ka asnjë gjurmë nga autorët.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 20:07

Dhunimi dhe grabitja e familjes në Klos, deputetja e PD-së: Prokuroria të zbardhë ngjarjen

Deputetja e Partisë Demokratike Dhurata Çupi ka reaguar pas ngjarjes së rëndë që ndodhi në Klos, ku familja Lleshi u dhunua e më pas u grabit. Çupi i kërkon prokurorisë dhe policisë që të zbardhet ngjarja.

> *'Ngjarja e rëndë kriminale e grabitjes dhe dhunimit të familjes Lleshi, në fshatin Dom, Klos ka prekur të gjithë banorët e kësaj zone. Siç edhe e deklarojnë banorët e fshatit , familja Lleshi njihet si familje punëtore, e ndershme e paqtë.*
>
> *Si deputete e tyre, në qarkun Dibër, kërkoj Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Rrethit Dibër të zbardhin menjëherë ngjarjen që ka tronditur komunitetin fisnik të Klosit. Vonesa në zbardhjen e ngjarjes janë rënduese për drejtorinë vendore të qarkut Dibër.*
>
> *Gjendja e pasigurisë në vend është e papranueshme . Jeta e qytetarëve duhet të jetë e barabartë, e sigurtë dhe me vlerë, si në Tiranë, Vlorë dhe Dibër.'- shkruan Çupi.*

Ora 10:47

Grabitja me armë dhe dhunimi i familjes në Klos, policia jep detajet: Janë shoqëruar 6 persona

6 persona janë shoqëruar nga policia e cila po zhvillohen hetimet e para për ngjarjen e rëndë të ndodhur në Klos të Dibrës, ku një familjeje u grabitën disa mijëra euro.

> *"Rreth orës 03.30, datë 02.10.2022, në fshatin Dom, Klos, persona ende të paidentifikuar dyshohet nën kërcënimin e armës, janë futur në banesën e shtetases Sh.Ll, e cila ndodhej në banesë së bashku me djalin e saj dhe me forcë ju kanë marrë një shumë të konsiderueshme vlerash monetare. Shërbimet e Policisë kanë shoqëruar 6 persona në Komisariat, dhe vijon kontrolli i zonës për kapjen e personave të përfshirë në këtë ngjarje. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes", thuhet ne njoftimin e policisë.*

Ora 10:12

Si ndodhi grabitja në Klos, autorët lidhën nën e bir dhe i dhunuan, më pas morën mbi 8 mijë euro

Të tjera detaje janë zbuluar nga grabitja në Klos. Mësohet se është grabitur familja e Përparim Lleshit.

Dyshohet se grabitësit kanë hyrë me forcë duke shqyer dyert e shtëpisë, ku më pas kanë rrahur me qytat e armëve Përparim Lleshin dhe nënën e tij dhe pas i kanë lidhur me litar. Më pas grabitësit kanë marrë nga shtëpia 8 mijë euro, 1 milion lekë të vjetra dhe sende me vlerë.

Një i afërm thotë se djali ka pësuar fraktura të mëdha në kokë, (4 fraktura) dhe nëna po ashtu, pasi janë goditur me qytën e automatikut.

> *"Çunin e familjes e kanë rrahur tmerrësisht, e kanë lidhur dhe më pas i kanë vjedhur. Si lagje nuk na ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë. Se dimë se ça po hyn e ça po del. Kush bën kështu veprimesh, duhet pushkatuar. Po është hequr pushkatimi. Ishte nëna me fëmijën vetëm në shtëpi", tha i afërmi, që është dhe banor i zonës.*

Sl.E./M.Q./Shqiptarja.com

TAG: Klos Diber grabitje perparim lleshi

Komento

Komente

Per liken: 02/10/2022 14:45
O like Po nderroje kaseten mor burre se ngele tek Saliu, dorezohu njehere refuzoje Suflaqen.
Përgjigju

Likja: 02/10/2022 12:46
Keto jane mbeturinat e sali gallates
Përgjigju

Arbërori: 02/10/2022 10:39
Tani kan filluar të veprojn hordhit Edvin shkjaut shqipfolës nga serbia
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Qeveria shtyn zbatimin e fashës 800 kWh për çmimin e energjisë, mendoni se është zgjidhja e duhur?

PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Bulqizë, vijon regjistrimi i tokës bujqësore! 1600 pasuri regjistrohen në emër të pronarëve në Gjoricë
25 Shtator, 12:15

Sport

Hakik Çekiçi, nga imam në trajner ambicioz në fushë: Ëndrra është një stadium në Bulqizë
Mahir Jangulli
23 Shtator, 11:24

Kronikë

Grabitën me kallashnikov pikën e karburantit në Lezhë, në pranga 2 vëllezërit! Morën 100 mijë lekë, vodhën dhe celularin e shitësit (VIDEO)
23 Shtator, 09:36

Bota

Ngjarje e pazakontë në Spanjë! Pas debatit me partneren, tenton të grabisë makinën, por ngec në shkallët e metrosë së Madridit (VIDEO)
24 Gusht, 17:26

Bota

Vjedhje 'live' në Spanjë! I rrëmben çantën një gruaje kur pushuesi po jepte një prononcim', televizioni spanjoll transmeton momentin
18 Gusht, 22:34

Drejt Punës

'Shqipëria Turistike'/ Zerqani, fshati me tradita i Dibrës, shtëpia monument kulture e Mustafa Shehut dhe pylli mistik "Zabeli i Vakëfit"
Mahir Jangulli
30 Korrik, 11:00

REPORT TV
KONTRAST
Nga DENIS MINGA & LORENC VANGJELI
E HËNË - E ENTJE
18:00 - 19:00

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje